

VENDIM
Nr.1604, datë 10.12.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE SHETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS MOGLICË TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Moglicë, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Moglicë të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.16, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shetërore në komunën Moglicë të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Moglicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Moglicë		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
65	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi
50-64	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
42-49	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
16-4 1	Varrezat publike	Në pronësi
1-15 (vetëm trojet e lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
1-15 (vetëm sheshet), 486-494	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
495-510	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
418-420,422-424,426-428,430-432,434-436,438,439,441-443,445,446,448-450,452-454,456,457,459-461,463,464,466,468-470,472-474,476-478,480-482	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
421,425,429,433,437,440,444,447,451,455,458,462,465,467,471,475,479,483	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi